



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:283875

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06212558

C.nr.3120/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.S. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 3,683.75 euro, jashtë seancës, me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.S. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kualifikimit master për periudhën 04.10.2021 – 31.01.2023, për 16 muaj, duke llogaritur nga 147.35 euro për çdo muaj, t'ia paguaj paditëses shumën prej 2,357.6 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 18.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar më tepër se shuma e aprovuar si në pikën I të këtij dispozitivi, për shumën prej 1,326.15 euro.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 145.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 18.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 3,683.75 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) "Rexhep Elmazi" në Gjilan, si mësimdhënëse. Përkundër kualifikimit të saj master,

asnjëherë nuk është kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën 01.01.2021 – 31.01.2023, e njëjta është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), kurse e paditura nuk e ka kompensuar për kualifikim fare. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 3,683.75 euro, të llogaritur për 26 muaj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 41.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i provuar edhe nga kontrata e punës e lidhur në kohë të caktuar mes paditëses dhe të paditurës, nr.prot.46 e dt.15.02.2022 dhe e dt.04.01.2023) dhe paga bazë e saj është 421.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Paditësja është e punësuar te e paditura nga viti 2021 dhe deri më datë 15.11.2023 vazhdon të jetë mësimdhënëse në SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan, mirëpo data e saktë e krijimit të marrëdhënies së punës nuk është përshkruar (vërtetimi nr.prot.664/2023 i dt.15.11.2023 i lëshuar nga kjo shkollë). Në SHFMU “Abaz Ajeti” në Gjilan, paditësja ka qenë e punësuar për

periudhën 04.10.2021 – 30.06.2022 (vërtetimi nr.prot.185/2022 i dt.30.06.2022 i lëshuar nga kjo shkollë).

Nga këto vërtetime, gjykata konstatoi se data e saktë për vitin 2021 e krijimit të marrëdhënies së punës me paditësen dhe SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan nuk mund të provohet, ndërsa provohet fakti se për vitin 2022 dhe 2023, e njëjta vazhdon të jetë mësimdhënëse në këtë punë. Ndërsa, nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Abaz Ajeti” në Gjilan provohet se paditësja ka themeluar marrëdhënien e punës më datë 04.10.2021.

Nuk është kontestuese se e njëjta ka diplomë të nivelit master nga Kolegji AAB (fakt i vërtetuar nga diploma nr.400/20 e dt.10.06.2022), dhe se për kualifikim nuk është kompensuar fare (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditëses nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritorë, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, pasi nuk është paguar për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro, si dhe periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 18.12.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga muaji janar 2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi bazuar në vërtetimet e sjellura nga vet paditësja konstatohet se e njëjta nuk ka qenë në marrëdhënie pune për tërë periudhën për të cilën kërkon të kompensohet. Në rastin konkret, paditësja ka kërkuar të kompensohet për periudhën 01.01.2021 – 31.01.2023, mirëpo e punësuar te e paditura ka qenë për periudhën 04.10.2021 – 31.01.2023, përkatësisht për 16 muaj të llogaritur për periudhën që e kompenzon edhe vendimi i qeverisë. Prandaj, gjykata ia njohi vetëm ato muaj sa e njëjta ka qenë e punësuar te e paditura dhe nuk është kompensuar për kualifikim, kurse pjesën tjetër të kërkuar më tepër sesa periudha që ka qenë e punësuar te e paditura, gjykata e refuzoi të pabazuar.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë sa i përket periudhës sa që njëjta ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.3120/23, më datë 25.09.2024

Gjyqtarja,  
Erlinda Elezi-Tosku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.